

Shpallen konkurset për pranimin e studentëve në programin studimor Bachelor ‘Siguri Publike’ për vitin akademik 2026/2027



Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) njofton zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike se janë shpallur konkurset për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve në programin studimor Bachelor "Siguri Publike", në Fakultetin e Sigurisë Publike, për vitin akademik 2026/2027.

Në kuadër të këtyre konkurseve janë miratuar gjithsej 55 vende nga Agjencia e Kosovës për Akreditim për regjistrim të studentëve për vit akademik, të ndara sipas institucioneve si në vijim:

- Policia e Kosovës - 26 vende;
- Shërbimi Korrektues i Kosovës - 20 vende;
- Agjencia e Menaxhimit Emergjent - 8 vende;
- Inspektorati Policor i Kosovës - 1 vend.

Kushtet e përgjithshme për aplikim janë:

- Të kenë përfunduar me sukses shkollimin e mesëm, të dëshmuar me diplomë;
- Të jenë të punësuar në institucionin përkatës të sigurisë publike.

Kushtet e veçanta për aplikim, dokumentacioni i nevojshëm, mënyra e testimit dhe procedurat e tjera janë të përcaktuara në konkurset e veçanta të shpallura nga secili institucion i sigurisë publike.

Afati për aplikim është nga 3 gusht 2026 deri më 17 gusht 2026.

Procedurat e pranimit, duke përfshirë pranimin e aplikimeve, verifikimin e dokumentacionit, organizimin e testimit, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, administrohen nga institucionet përkatëse të sigurisë publike, në përputhje me konkurset e shpallura prej tyre.

Në Fakultetin e Sigurisë Publike të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike do të regjistrohen kandidatët që i përfundojnë me sukses procedurat e pranimit dhe përzgjidhen sipas konkurseve të administruara nga institucionet e sigurisë publike, në kuadër të kuotave të miratuara.

Për informata më të detajuara lidhur me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për aplikim, dokumentacionin e nevojshëm, mënyrën e testimit, procedurat e përzgjedhjes dhe çështjet e tjera që lidhen me procesin e pranimit, kandidatët duhet t'u referohen konkurseve të veçanta të shpallura nga institucionet përkatëse të sigurisë publike, të cilat janë bashkëngjitur këtij njoftimi.

Për informata shtesë lidhur me programin studimor, kandidatët mund të kontaktojnë Fakultetin e Sigurisë Publike në:

E-mail: info.fsp@aksp-ks.org

Tel.: +383 (0)28 590 070